



K.DH.SH.II.nr.233/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, kryetare kolegjit Franciska Zhitija Ymeri, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.N.P “CTA” ShPK me numër unik identifikues 811322776 me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson drejtori Z.M., kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Erëleta Popaj, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.19/22 të datës 26.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet ankesa e paditësit, .N.P “CTA” Sh.p.k me seli në Prishtinë e datës 03.01.2024, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.19/22 të datës 26.10.2023, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar

kërkesëpadinë e paditësit N.N.P “CTA” ShPK, Anulohet pika II. E vendimit PSH.nr. 573/18 e datës 23.11.2018 i nxjerrë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit si i kundërligjshëm. Nën pikën II. Obligohet i padituri Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që paditësit N.N.P “CTA” Sh.p.k, në emër të dëmit të Shkaktuar lidhur me aplikimin në këtë aktivitet të prokurimit ti paguaj shumën prej 35.40€ (tridhjetë e pesë euro e dyzet cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë datë 20.12.2018 e deri në përmbushjen përfundimtare në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Nën pikën III. Refuzohet pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit N.N.P “CTA” Sh.p.k për kompensimin e dëmit në emër të fitimit të humbur në shumë prej 30,066.65€. nën pikën IV. Ky aktgjykim zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter detyrues. Nën pikën V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij vendimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar paditësi përmesë përfaqësuesi të tij, për shkak të; shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, aplikimit të gabuar të Ligjit material dhe konstatimit të gabuar të gjendjes së fakteve, propozon që aktgjykimin i atakuar të priset dhe çështja ti kthehet Dhomës së Shkallës së parë në rishqyrtim dhe në rivendosje apo kërkesëpadia e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar dhe përveç anulimit të vendimit PSH.nr.573/18 të datës 23.11.2018 të obligohen të paditurat të kompensoj edhe fitimin e humbur në vlerën prej 30,066.65€.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin, PSH.nr.573/18 të datës 23.11.2018 në pikën I. të dispozitivit është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.N.P “CTA” Sh.p.k-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit (Labororit) të Mikrovinifikimit në Rahovec” me numër të prokurimit: 203-18-3748-521 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK/ Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit

Rural MBPZHR). Në pikën II. Vërtetohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit (Labororit) të Mikrovinifikimit në Rahovec” me numër të prokurimit: 203-18-3748-521 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK/ Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural MBPZHR). Në pikën III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në pikën IV mos respektimi këtij vendimi detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237 Ligjin 05/L-068 dhe Ligji 05/L-092 të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. Nën pikën V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NNP “CTA”- Prishtinë aprovohet pjesërisht si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Nën pikën VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kundër Vendimit të paditurit, paditësi inicion konflikt administrativ, me padi i drejtohet gjykatës. Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, në këtë çështje juridike administrative, me datë 11.10.2023, mban seancë të shqyrtimit kryesor në prani të përfaqësuesit të palës paditëse, në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditurit të parë OSHP e në prani të përfaqësueses të paditurit të dytë MBPZHR dhe pas administrimit të provave, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, dhe e refuzon pjesërisht si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Me arsyetim se Gjykata nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri i dytë OSHP ka vepruar në kundërshtim me Ligjin 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjin për Prokurimin Publik, ku në pikën II të vendimit kontestues ka lënë në fuqi vendimin e autoritetit kontraktues të datë 27.11.2018 ndërsa në arsyetimin e vendimit i njëjti konstaton se procedura e prokurimit ishte zhvilluar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik. Gjykata konstaton se i padituri i parë përmes vendimit të goditur me padi gabimisht kishte vlerësuar se paditësi nuk i kishte plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, kjo pasi që gjykata nga ekspertiza nga lëmia e prokurimit publik konstaton se paditësi N.N.P. “CTA” është i përgjegjshëm dhe i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Andaj gjykata vlerëson se i padituri i dytë gabimisht ka konstatuar se OE fitues është i përgjegjshëm dhe ka shpërblyer me

kontratë, pasi që në bazë të provave të administruara në gjykatë rezulton se ky OE nuk kishte plotësuar kapacitetin teknik dhe profesional, dhe rrjedhimisht është dashur të shpallet i papërgjegjshëm. Gjykata gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të ankimuar iu referua edhe nenit 31 par.6 të rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik. Gjithashtu iu referua nenit 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, gjykata konstaton se i padituri ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit mbi kriterin e dhënies së kontratës, çmimin më të ulët kjo vërtetohet edhe nga Njoftimi për Kontratë i datës 24.05.2018 ku në kapitullin IV.2) është përcaktuar se kriteri i dhënies së kontratës është çmimi më i ulët. Andaj duke qenë se sipas ekspertizës së prokurimit gjykata vlerësoi se OE i rekomanduar për kontratë N.N.P “Contrumax” ka qenë i përgjegjshëm, atëherë gjykata vlerëson se autoriteti kontraktues është dashur që paditësin N.N.P “CTA” ta rekomandoj për kontratë pasi që i njëjti ka qenë ofertues i përgjegjshëm me çmimin më të ulët dhe atë prej 138,391.49€, gjykata vendosi që të anulohet si të kundërligjshëm pikën II. Të dispozitivit të vendimit PSH.nr.573/18 të datës 23.11.2018 për shkak se vendimi kontestues i të paditurit është nxjerr në kundërshtim me nenin 59 dhe 60 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, gjykata bazuar në nenin 46 par 3 të LKA-së vendosi si në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Gjykata po ashtu refuzoi kërkesëpadinë e paditësit sipas precizimit të bërë në seancën e datë 11.10.2023 për kompensimin e dëmit në formën e fitimit të humbur në shumë prej 30,066.65€, pasi që gjykata vlerëson se një kërkesë e tillë nuk ka mbështetje ligjore. Paditësi, kërkesën lidhur me shpërblimin e fitimit të humbur e ka mbështetur në nenin 17 dhe 26 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gjykata vendosi për çështjen mbështetur në nenin 46 par.4 të LKA-së, pasi që periudha për të cilën është planifikuar realizimi i aktivitetit të prokurimit i shqyrtuar në këtë konflikt administrativ ka përfunduar dhe duke qenë se të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për anulimin e vendimeve kontestuese, gjykata vendosi vetë për çështjen administrative si në pikën I. II. dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit. Ndërsa lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit, gjykata veprroi në kuptim të nenit 46 par.5 të LKA-së, ashtu që vendosi që paditësi të kompensohet në shumën prej 35.40€ në emër të shpenzimeve të bëra gjatë aplikimit në këtë aktivitet të prokurimit ndërsa refuzoi kërkesën për kompensimin e dëmit në emër të fitimit të humbur në shumën prej 30,066.65€, gjykata vlerësoi edhe provat tjera të administruara por të njëjtat nuk i elaboroi secilën veç e veç pasi që nuk kishin ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështja.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor konkludimin e tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, andaj kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë, ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore dhe procedurale në përputhje me Ligjin nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA, Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikë e Kosovës (LPP) dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, bazuar në provat e administruara pretendimet e palëve ndërgjyqëse, thënieve në padi si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar. Organi i paditur është dashtë që duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të nxjerr vendim përmbajtjesor ashtu si parashihet me nenin 86, të LPA-së, i cili do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjen faktike të çështjes, bazuara në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ deklarimin bazës ligjore në të cilat bazohet akti. Arsytimi të jetë i qartë dhe i argumentuar lidhur me mënyrën e vendosjes ashtu si parashihet në nenin 85 të LPA, kur me akt, kufizohen mohohen, shuhen apo preken interesat ligjore ose, vendosen detyrime apo ndëshkime. Nga këto fakte rezulton se i padituri me mënyrën e vendosjes ka nxjerrë vendim jo të drejtë dhe jo ligjor ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LPA-së, sa i përket pikës II. të dispozitivit të vendimit të paditurës. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë ka vendosur kur e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar pikën II të vendimit PSH.nr. 573/18 e datës 23.11.2018 i nxjerrë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit si i kundërligjshëm, është obliguar i padituri Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që paditësit N.N.P “CTA” Sh.p.k, në emër të dëmit të Shkaktuar lidhur me aplikimin në këtë aktivitet të prokurimit ti paguaj shumën prej 35.40€ (tridhjetë e pesë euro e dyzet cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë datë 20.12.2018 e deri në përmbushjen përfundimtare në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimi. Ndërsa është refuzuar pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit N.N.P “CTA” Sh.p.k për kompensimin e dëmit në emër të fitimit të humbur në shumë prej 30,066.65€. Andaj, bazuar në nenet 13 par.1 nën par. 1.12 lidhur me par.5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 par.3 dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata me rastin e vendosjes lidhur me dëmin real dhe fitimin e humbur ka theksuar se duhet të përmbushen dy kritere bazë si ajo që dëmi të ketë bazë ligjore si dhe të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit dhe pasojës derisa ka përmendur arsyet kur ky dëm mund të kërkohet, vlen të theksohet fakti se objekt kontesti përveç anulimit

të vendimit ka qenë edhe kërkesa për kompensim dëmi dhe fitim të humbur dhe kërkesa bazohej në dispozitat e nenit 173 të LMD-së në ndërlidhje me nenin 17 dhe 26 të LKA-së, si dhe nenin 119 të LPP-së par. 2 dhe 3. Kolegji vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditësit lidhur me fitim e humbur dhe kompensimin e dëmit janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e Dhomës së Shkallës së Parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, Kolegji vlerëson së aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë është në pajtim me dispozitat ligjore, pasi që gjykata me të drejtë ka vlerësuar se asnjë dispozitë ligjore nuk e njeh dëmin e pësuar si pasojë e mos-fitimit të kontratës nga një ofertë publike. Baza ligjore do të krijohej në momentin e dhënies së njoftimit për dhënien e kontratës dhe kalimit të afatit për paraqitjen e ankesës përkatësisht vërtetimit të njëjtit nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, në rast ankese, dhe mos veprimit të autoritetit kontraktues në bazë të atij njoftimi.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se nga shkresat e lëndës dhe deklaratimet gjatë shqyrtimit gjyqësor konsistojnë në atë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale në raport me paditësin kur ka vendosur për refuzimin e pjeshëm të padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit sa i përket çështjes së kompensimit të dëmit dhe fitimit të humbur. Këto pretendime ankimore nuk i aprovoi sepse vlerësoi se janë të paqëndrueshme, të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë, ku me të drejtë ka theksuar se fitimi i një kontratë nuk është e drejtë e garantuar por vetëm mundësi për operatorët ekonomik, andaj të njëjtëve me ligj iu mundësohet kompensimi i dëmeve reale që mund ti pësojnë nga procedurat jo të rregullta të prokurimit e që në rastin konkrete është nga ekspertiza financiare është konstatuar se paditësi ka pësuar dëm real në vlerë prej 35.40€ për të cilën Dhoma e Shkallës së Parë ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim të plotë me arsyetimin e dhënë dhe me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të njëjtat i ka administruar çka kanë ndikuar edhe në aplikimin e gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike nga gjykata. Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se janë të pa bazuara dhe të pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e

vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë, për shkak se vendimi i kontestuar i të paditurës përmban të meta të tilla esenciale të lartcekura që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Mbi këtë gjendje të fakteve Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson, se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të paditësit. Pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.233/24, me datë 22.04.2024

**Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri**